



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 2 korrik 2013, në orën 11:00, sala N-303
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Afrim Hoti, Albert Kinolli, Bali Muharremaj, Adem Grabovci dhe Imri Ahmeti.

Të ftuar: z. Besim Beqaj, ministër në MF, z. Mahir Yagcilar, ministër në MAP dhe Lars Lage Olofsson-auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutimi rreth sistemit të regjistrimit të pasurisë;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Diskutimi rreth sistemit të regjistrimit të pasurisë

Kryetari – KMFP në takimin e mbajtur më 22 maj 2013, ndër të tjera ka diskutuar edhe çështjen e raportit të trupës punuese lidhur me sistemin e menaxhimit të pasurisë, dhe lidhur me këtë nxori rekomandim që kjo trup punuese deri në fund të muajit qershor 2013 të hartojë një raport me shkrim për KMFP. Më 28.06.2013 grupi punues në përbërje prej Ministrisë së

Financave, Ministrisë së Administratës Publike dhe ZAP ka dorëzuar një raport me shkrim për KMFP, ku ka njoftuar për të arriturat në funksionalizimin e këtyre dy sistemeve.

Grupi punues sipas raportit propozon që: pasuria fikse mbi 1 mijë euro të mbahet vetëm në Free Balance, të mundësohet bartja e të dhënave nga Free Balanca në E-pasuri ku do të eliminohet regjistrimi paralel i të dhënave. Të ngiten kapacitete ku edhe pasuria fikse nën 1 mijë euro të regjistrohet në Free Balanc. Dhe deri në ngritjen e plotë të kapaciteteve, pasuria fikse të regjistrohet edhe në sistemin e E-pasurisë, të bëhet azhurnimi i bazës së të dhënave.

Në PVF të paraqitet të dhënat sa i përket Free Balances dhe E-pasurisë, Dhe se grupi punues propozon që të punohet intensivisht në ngritjen e kapaciteteve të zyrtareve për regjistrimin e pasurisë, si dhe ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për menaxhimin efikas dhe efektiv. Konkluzioni i përgjithshëm, sipas raportit të trupës punuese, është se edhe për një kohë të gjatë do të vazhdohet me funksionimin e këtyre dy sistemeve, si sisteme paralele, mirëpo me mundësi të transferimit të të dhënave nga njëri sistem në tjetrin.

Po ashtu kisha kërkuar një sqarim nga kryesuesi i grupit punuese se a do të ketë ndryshime në bazën juridike mbi të cilën operojnë këto sisteme?

Fatmir Plakiqi, drejtor në Thesar MF- Ne kemi drejtuar dy shkresa informuese për KMFP lidhur me progresin e arritjeve në avancimet në sistemet për regjistrim të pasurisë, shkresa e parë ishte në muajin prill që kemi informuar se është themeluar një grup punues teknik dhe me shkresën e dytë kemi informuar KMFP lidhur me të arriturat e grupit teknik dhe bashkë me këtë janë dhënë disa rekomandime. Pasuria mbi 1 mijë euro regjistrohet vetëm në Free Balanc dhe me pastaj do të bartet në E-pasuri. Ne jemi duke punuar në avancimin e sistemit të Free Balanc në versionin 7 dhe kjo do të mundësojë edhe regjistrimin e pasurisë nën 1 mijë euro. Ne jemi në përkrahje nga një projekt i Agjencisë Evropiane në fushën e menaxhimit të financave publike dhe kjo do të na ndihmojë shumë. Grupi punues ka mbajtur një varg takime dhe ka arritur deri te këto konkluzione.

Ramiz Lladrovci- KMFP është i interesuar që institucioneve buxhetore përmes MF dhe MAP-it t'ua lehtësojë regjistrimin e të dhënave në sistem dhe që të kenë një pasqyrë të sakët të pasurisë, dhe mos të kemi vërejtje nga ZAP në fushën e regjistrimit të pasurisë, ashtu siç kishim deri tani. Ky problem është ngritur, sepse ZAP ka hasur të gjetura. Mendoj që duhet të na jep informata ZAP, a do të jenë të gjetura nëse trupi i punës ka arritur pajtueshmëri? Ne na intereson që e gjetura të mos përsëritet. Pastaj, është mirë për Komisionin të kemi informata se do të ndodhin këto ndryshime dhe kur mund të presim, si p.sh. ndryshimi i UA.

Valbona Dibra –Kërkoi sqarime nga Grupi punues se cili nga sistemet për regjistrimin e pasurisë duhet ta ketë primatin - Free Balanca apo E-pasuria? Grupi punues me Raport ka dhënë disa rekomandime të cilat Komisioni i vlerëson shumë, mirëpo për të gjitha institucionet është e rëndësishme ta dinë se cili nga sistemet është me rëndësi parësore.

Është me shuam rëndësi që në Udhëzimi Administrativ (UA) të përfshin të gjitha propozimet që dalin nga Komisioni. Domethënë më UA të parashihet që në E-pasuri të regjistrohet pasuria nën 1000 euro, ndërsa mbi 1000 euro në Free Balanc. Me prioritet të saktësisë së informatave të jetë Free Balanc, sepse ka më shumë informata.

Imri Ahmeti – Tha se megjithatë po mbesin dy sisteme. Një nën 1000 euro e tjetri mbi 1000 euro. Më intereson se si është rregulluar kjo me UA dhe cila është mundësia e ndryshimit të UA? Grupi punues nuk ka rekomanduar ndryshimin e UA! A është pengesa në norma për të gjeturat e sistemit të menaxhimit të pasurisë? Kam përshtypjen se po zhvendoset problemi në një fushë tjetër, te normat ligjore. Nëse ka pasur pengesa ligjore, atëherë grupi punues është dashur të rekomandojë ndryshimin e këtij udhëzimi.

Fitim Sadiku MAP - UA ka dizajnuar sistemin E-pasurisë. Për harmonizimin e sistemeve grupi ka dalë me rekomandime konkrete dhe UA duhet të adaptohet me ndryshimet në kohë.

Kryetari – UA duhet të përfshij dhe sanksionet për mos përmbushje të obligimeve të dala nga ky Udhëzim. Cilin sistem do ta ketë ZAP burim të informacionit?

Zilif Lufi – Nuk është e tepërt të kemi dy sisteme. Ne kemi të bëjmë më tepër më mënyrë e evidentimit të pasurisë. Të dy sistemet janë të kontabilitetit material. Përparësia e njërit sistem ndaj tjetrit është se E-pasuria ka një përparësi që menaxhon me depot e materialit. Këtë nuk e ka SIMFK. Gjithashtu E-pasuria ka bërë regjistrimin e pasurisë nën 1000 euro dhe atë mbi 1000 euro për pasurinë fikse. Mendoj që këto dy sisteme duhet të ekzistojnë, sepse kanë të bëjnë me natyra të ndryshme, por me qëllim që informatat të mos dyfishohen, të kompletohen me njëra tjetrën. UA do të azhurnohet deri në fund të muajit shtator. Procesverbalet e OB-ve nuk kanë qenë të barazuara me sistemin.

Kryetari- Komisioni insiston që të kemi një sistem. Atë duhet ta bënë në koordinim me ZAP-in, i cili duhet të marrë pjesë gjatë hartimit të Udhëzimit. Deri në fund të muajit tetor duhet të trajnohen të gjitha OB-të për zbatim të këtij sistemi.

Murselj Haljilji – Komisioni ka diskutuar për unifikimin e sistemit në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë se cili sistem do të përdoret. Nëse vazhdojmë të kemi dy sisteme prapë do të kemi probleme. Nuk mund të vazhdohet më dy sisteme paralelisht. Pajtohem me propozimin e kryetarit kur thotë që me akte nënligjore duhet të ndëshkohen OB të cilat nuk përfillin regjistrimi pasurisë konform UA. Domethënë të bëjmë një pasqyrë të saktë që OB-të të dinë saktë se çka duhet të bëjnë dhe të ndëshkohen nëse nuk bëjnë. Të dy sistemet duhet të jenë të qarta për të gjitha OB-të. Detyrë e grupit punues ka qenë që të unifikohen në një grup. Nëse vazhdojmë të kemi dy sisteme atëherë nuk kemi bërë asgjë. Me një sistem të unifikuar do të zgjidhej problemi dhe kjo do të lehtësonte gjeneratat e ardhshme.

Fatmir Plakiqi- drejtor në Thesar MF- Theksoi se Thesari përgatitë pasqyrat financiare për të gjitha OB- të. Sistem bazik është sistemi i thesarit SIMFK. A duhet ne të marrim edhe sistemin e E-pasurisë, kjo duhet të shikohet. Ne mund t'i bartim, por nuk kemi arsye të bëjmë dualizma të sistemit dhe shumë shpejt do të inkorporohet edhe pjesa nën 1000 mije euro. Fakti që rekomandimi i grupit është që të dhënat nën 1000 mijë euro mbahen në E-pasuri nuk kemi regjistrime të dyfishta. Në Free Balanc nuk regjistrohen nën 1000 euro, por ato barten prej Free Balanc. UA ka specifikuar që të gjitha pasuritë duhet të mbahen në libra. UA mund të ndryshohet, kjo do të ndodhë në të ardhmen. Por paraprakisht duhet të jemi dakord se cilat pjesë duhet ndryshuar. UA thotë se pasuritë mbi 1000 euro regjistrohen në SIMFK, ndërsa nën 1000 euro dhe stoqet mbahen në regjistra kontabël. Pra OB- ja lejon të ketë një sistem, përfshirë edhe stoqet për pasurinë nën 1000 euro. Tash kemi avancuar që pasuria nën 1000 euro të bartet te thesari, ndërsa mbi 1000 euro te MAP. Ne nuk mund të bartim të dhëna nëse nuk e kemi të regjistruar pasurinë në të gjitha OB- të. Pra, përgjegjësia në radhë të parë bie në ZKA të OB-ve që të regjistrohen të gjitha pasuritë. Pastaj me rekomandime të ZAP-it do të analizojmë mekanizma shtesë për obligimin që të regjistrohen të gjitha pasuritë. Grupi për gjendjen aktuale u pajtuan që të mos regjistrohen dy herët të dhënat. Mbi 1000 vetëm në Free Balanc nën 1000 vetëm në E-pasuri. Sa i përket shkrirjes në një sistem jam i mendimit se të dy sistemet duhet të ekzistojnë, sepse E-pasuria përfshinë edhe stoqet, ato lëvizin përditë. ZAP njeh pasqyrat që prodhon MF përkatësisht thesari. Grupi punues ka dalë me rekomandime dhe ndër të tjera shprehet *“thotë formimi i grupit punues për ndryshimin e udhëzimit administrativ”*.

Ramiz Lladrovci – Problemi është se OB-të nuk kanë pasur të regjistruara pasuritë. Nuk kemi dy sisteme, mund të themi kemi *“një sistem e pak”*, sepse pasuria nën 1000 euro nuk figuron në sistemin e Free Balanc në Ministrinë e Financave.

Artan Venhari - E gjetura ka qenë se ka pasur dy programe të cilat nuk kanë komunikuar. Qëllimi është kuptuar shumë mirë, që OB-të t'i futin të dhënat në një sistem në mënyrë që të mos ketë dualizëm të të dhënave. Nuk do të ketë dallim midis të dhënave, duke ndarë një bazë të shënimeve. Problemi ka qenë që për shkak të dallimeve në programe nuk kemi arritur në vlera të njëjta. Qëllimi kryesor është që të regjistrohet pasuria dhe tani është arritur një akordim që deri në cilën vlerë të regjistrohen në njërin e në cilin në tjetrin sistem. OB-të nuk kanë nevojë që të njëjtat të dhëna t'i fusin në dy programe kur kjo evitohet, atëherë kemi arritur të kemi një vlerë të saktë të pasurisë në sistem.

Hajredin Hyseni, zv. ministër MAP - Fakti që MAP dhe MF ka formuar Grupin e përbashkët tregon që janë akorduar për të adresuar të gjeturat e ZAP-it lidhur me sistemin e menaxhimit të pasurisë. MAP pajtohet me ndryshimin e UA dhe do ta bëjmë atë në pajtueshmëri me MF.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike, deri në mesin muajit shtator të hartojnë Udhëzimin Administrativ i cili do të përcaktojë saktë sistemin e menaxhimit të pasurisë (SIMFK-E-Pasuri), duke ndarë përgjegjësitë e njërit sistem ndaj tjetrit. Lidhur me këtë do të njoftohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu